

**ZIAUDIN KODRA****VINCENC STRATIGO**

(1822-1885)

*(me rastin e tetëdhjetvjetorit të vdekjes)*

Vinçenc Stratigo është një nga figurat më interesante dhe tërheqëse arbëreshe të shek. XIX. Revolucionar i flaktë, njeri i fjalës dhe i veprimt, Stratigoi luftoi me pendë dhe pushkë në radhët garibaldine kundra forcave reaksionare, borgjezisë së pasur të Veriut dhe latifondistëve të mëdhej të Jugut si dhe kundra klerikalizmit reaksionar dhe Papatit. Lindur dhe rritur në mes të popullit punëtor, bujqëve të varfër dhe argatëve të Kalabrisë, jeta e të cilëve ishte plot helm dhe lot, ai mbrojti me vendosmëri dhe ngulm interesat e këtyre shtresave, sidomos të vegjëlisë fshatare kundra formave mesjetare të shfrytëzimit ekonomik, që ruanin dhe mbrojnë klasat e pasura konservatore.

Stratigoi ze një vend me rëndësi edhe në historinë e letërsisë arbëreshe. Me krijimet e tija poetike hynë në letërsinë shqipe idetë socialiste, idetë e çlirimit të vegjëlisë nga zgjedha shoqërore dhe ekonomike. Ai ka meritën që i pari pasqyroi nga pozita prej demokraci revolucionar gjendjen e rëndë të masave të shfrytëzuara të popullit dhe mori anën e tyre në luftën që bënin për një jetë më të denjë njerëzore.

\* \* \*

Stratigoi lindi më 16 dhjetor të vitit 1822 në Ungër, koloninë më të madhe arbëreshe të Kalabrisë. Me më pak se 5 mijë banorë, Ungra ka pasur që me kohë një jetë pak a shumë të gjallë për ato anë të varfëra, se kryporja që ndodhet edhe sot e kësaj dite në të hyrë të fshatit, u ka dhënë punë qindra punëtorëve, ndonse me pagë shumë të vogël, për atë punë të rëndë e të vështirë që bënin ashtu si na flet Vinçenc Stratigoi në poemë e tij «Proletari». Në kohët moderne kjo koloni arbëreshe e ka mbajtur gjithënjë lart flamurin e lirisë. Serafin Gropa me shumë të drejtë e ka quajtur vatër konspiracionesh që shpesh herë organizoheshin në Kalabri. Familjet arbëreshe që u shquan në drejtimin e lëvizjeve revolucionare të fshatit kanë qënë të shumta; ndër to përmendet ajo e Damasve, Samengovet, Stratigovet, Fregavet, etj.

Sipas studjuesit të njohur të letërsisë arbëreshe, A. Stratikoit, mësimet e para, poeti-luftëtar i ardhshëm, i mori në shtëpinë e vet, së pari nga i ungji, Luigj Stratigo, klerik orthodhoks me kulturë të shëndoshë klasike, pastaj edhe nga i jati, Ëngjëll Stratigo, të cilët, me sa duket, bënin pjesë në organizatën e fshehtë karbonare që vepronte në Ungër.

Për formimin e Vincencit me idetë përparimtare dhe antifeudale ka ndikuar sidomos qëndrimi i tij në kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër të Koronës, ku hyri në moshën 12 vjeç. Në kolegji vajti rreth vitit 1834, kur kishin hyrë tanimë idetë përparimtare revolucionare të karbonerisë

dhe të «Giovine Italia» të Macinit dhe kur kolegji ishte bërë «çerdhe nëpërkash» dhe vatër «djajsh», si u quajt më vonë kjo qendër kulture dhe vatër e idevet përparimtare kundra feudalizmit dhe sundimit të huaj. Në kolegji poeti i ardhshëm revolucionar duhet të ketë dëgjuar për historinë e lavdishme të stërgjyshërvet të vet në kohën e Skënderbeut, për një folklor të pasur dhe të bukur në gjuhën e vet, për një zhvillim të letërsisë së arbëreshëve që nga shek. XVIII. Siç duket nga shkrimet e poetit, në poezi nga format dhe nga figurat dhe në prozë, nga citatet e shumta që sjell prej autorësh latinë dhe grekë, në atë kolegji Vincenç Stratigoi mori një kulturë të shëndoshë klasike, duke mos lënë pas dore as shkrimtarët modernë. Në shkrimet e tija në prozë, italisht, shumë herë, pranë autorëve klasikë dhe historianëve të lashtësisë greko-romane, citon edhe ekonomistë modernë. Me këta të fundit duket se është njohur në kohën e studimevet universitare në Napoli. Si të gjithë nxënësit e tjerë të atij kolegji, edhe Vincenç Stratigoi e la atë institut si u pajis me një kulturë të mirë klasike. Është fakt i pakundërshtueshëm se të gjithë nxënësit e Kolegjit të Shën Adrianit në Shën Mitër, kur venin nëpër shkollat e larta të Napolit e të Romës, po më shumë të Napolit, sa merresh vesh se vinin nga ai kolegji, nuk i shtroheshin asnjë provimi. Në shumë konkurse që bëheshin për ndonjë vënd nëpunësie, të parët dilnin nxënësit e kolegjit të Shën Adrianit. Nga ai kolegji në shek. XVIII-XIX dolën personalitete të shquara të kulturës letrare e juridike të Italisë së Jugut dhe shumë personalitete politike arbëreshe, që u shquan në luftën revolucionare për çlirimin e Italisë së Jugut nga feudalizmi. Që kur ishte në kolegji, Vincenç Stratigoi, duhet të ketë dëgjuar a të jetë njohur me Domenik Maurin, drejtonjës të ardhshëm arbëresh të lëvizjes revolucionare në Kalabri, që udhëhoqi forcat e luftëtarëve për liri në betejën e Kampotenezës më 1848.

Pasi mbaroi shkollën e mesme, Stratigoi u nis për në Napoli, ku ndoqi fakultetin e drejtësisë. Njeri me temperament luftëtar dhe dashuri të zjarrtë për lirinë, krijohet i tëri në lëvizjen revolucionare të studentëve kundër burbonëve. Por, pa mbaruar studimet, më 1844 detyrohet të kthehet në fshat, kur qeveria e Ferdinandit II të Napolit u hodh me egërsi të shtypë lëvizjet e studentëve. Qysh në këtë kohë, policia burbone e ndjek dhe e vëzhgon si konspirator të rrezikshëm.

Vala revolucionare që përfshiu Evropën më 1848, revolucionin e shkurtit në Paris dhe veçanërisht kryengritja e marsit në Vienë, i dhanë një shtytje të fortë lëvizjes nacional-çlirimtare në Itali. Në Milano, Venecia, Modena, Parma dhe në qytete të tjera plasën kryengritje të popullit kundra ushtrive austriake dhe veglave të tyre. Në luftë kundra Austrisë hyri mbretëria e Sardenjës dhe më vonë nën presionin e masave popullore sunduesit e Toskanës, mbreti Ferdinand i II Burbon i Napolit dhe Papa Piu IX. Por disfatat që filluan të pësojnë ushtritë piemonteze, i dhanë shkas reaksionit feudal t'i kthehet lëvizjes revolucionare të popullit italian dhe ta mbysë në gjak. Mbreti Ferdinand i II i Napolit i tërhoqi ushtritë e veta dhe më 15 maj 1848 mori një varg masash të tjera kundërrevolucionare, tërhoqi kushtetutën që kishte lëshuar më 29 janar t'atij viti, shpërndau parlamentin dhe zhdukuri të gjitha reformat liberale të fituara më parë nga populli. Me këto veprime Ferdinand i II Burbon e shtoi mërinë e popullit kundra despotizmit dhe sundimit të huaj dhe bëri që të plasi revolucionin, i nxitur më shumë nga studentët. Qeveria burbone dëboi nga Napoli 15 mijë studentë të krahinave të jugut, ndër të cilët edhe shumë arbëreshë të Kalabrisë, që u kthyen në fshatrat e tyre. Me ta, në maj

1848 kthehet edhe V. Stratigoi bashkë me deputetin Domenik Mauro nga Shën Mitri dhe vëllezërit Domeniko dhe Anxhelo Damis nga Ungra. Në verë të 1848 në Kalabri shpërtheu një kryengritje e madhe fshatare. Studentët arbëreshë që u kthyen nga Napoli organizuan forcat në luftë dhe zhvilluan betejën e njohur të Kampotenezës, që udhëhoqën Domenik Mauri e Domenik Damisi, në të cilën mori pjesë edhe poeti ynë Vincenc Stratigo me të 200 vullnetarët ungriotë; por kryengritja u shtyp me zjarr dhe hekur.

Pas shtypjes së kryengritjes, filloi një reaksion i tërbuar me arrestime, burgime, ekzekutime dhe internime në masë të fshatarëvet. Të arrestuarit ishin kaqë shumë, sa gjyqet e Kosenxës zgjatën nga 1848 gjer më 1853, duke e degdisur pjesën më të madhe nëpër burgjet e tmerrshme të ishujvet përballë Napolit, sidomos në Proçida. Vincenc Stratigo shpëtoi nga arrestimi, po u dënua me internim, në Badolato. Masa shtypëse u morën nga autoritetet edhe kundra të jatit të poetit, Anxhelo Stratigo, duke e transferuar në Tirolo a Muro, ku ishte përhapur kolera dhe ku më vonë ai u prek nga kjo sëmundje më 1855. Por këto masa që u morën kundra tij dhe familjes së tij, dënimi i shokëvet të luftës me vdekje, burgimet dhe internimet e të tjerëve, ia shtuan edhe më tepër shpirtin revolucionar Stratigoit. Megjithëse i vëzhguar vazhdimisht, ai zhvilloi një propagandë të fshehtë për të mbajtur gjallë idetë e revolucionit; shkruan vargje shqip e italisht, prozë italisht, që qarkullojnë ilegalisht ndër arbëreshët.

Më 1852 Vincenc Stratigo shkroi një hymn, me frymë të poezisë popullore, për nder të Shën Ilisë. Fshatarët e kënduan atë në kor, në procesion, në qershor të atij viti, kur ishte festa e këtij shënjtori.

Më 1856-57 plasën konspiracionet maciniane; akte revolte kishin ndodhur në Siqili; më 8 dhjetor 1856, arbëreshi nga Shën Benedikti, koloni e Kalabrisë, Axhesila Milani, bëri atentatin kundra jetës së Ferdinandit të II-të të Napolit, duke e plagosur me bajonetë gjatë një reviste ushtarake në sheshin e Armëvet në Napoli, kurse më 20 qershor 1857 një grup refugjatësh dhe detarësh, të udhëhequr nga Karl Pizakane, i hypi vaporet «Kaljari» në Gjenovë, drejtuar për Tunis. Gjatë udhës e rrëmbyen anijen, e drejtuan për në Ishullin e Poncës, i liruan të burgosurit e atij burgu të tmerrshëm të mbretërisë së Napolit dhe, si zbarkuan në Sapri, në krahinën e Salernos, shpresuan të bashkoheshin me kryengritësit e Basilikatës dhe të drejtoheshin për në Napoli, ndërsa në Gjenovë shokët do të zinin qytetin me kalatë dhe do t'u dërgonin ndihma. Po grupi u rrethua në Sapri prej xhandarëvet burbonë më 30 qershor dhe Pizakane ra heroikisht.

Në prill të vitit 1958 plasi lufta e Italisë, në aleancë me Francën kundra Austrisë, e cila megjithëse u nis nga konsiderata politike të tjera, pati përkrahjen e masave popullore të Italisë të cilët donin çlirimin e atdheut nga zgjedha austriake. Krahas ushtrive të rregullta, në të mori pjesë edhe Garibaldi në korpusin e vullnetarëve të vet, të cilët lanë nam nëpër Lombardi me aktet e tyre heroike.

Në këtë vit, pas triumfit të armëvet italiane në Lombardi dhe në Emili për çlirimin dhe bashkimin e vëndit nga zgjedha austriake, përhapet fryma e një kryengritje të përgjithshme edhe në Italinë e Jugut. Ndër udhëheqësit kryesorë që do t'i inkurajojë dhe do t'i nxisë masat e fshatarëvet arbëreshë në këtë luftë çlirimi dhe bashkimi është Vincenc Stratigo me fjalën e tij prej poeti dhe prej oratori. Kështu më 16 korrik 1859, i ndihmuar nga bashkëfshatarët arbëreshë Pjeter Iriani, të cilit Zef Serembe i ka kushtuar një ode të tërë dhe Cezare Martinos, në një shesh të Ungrës, Vincenc Stratigo i foli turmës së fshatarëvet për t'i nxitur në kryengritjen

e përgjithshme. Këtë skenë e përshkruan kështu Serafin Gropa në veprën e vet rreth luftës së arbëreshëve për liri. «... si Demosten i ri i shkundi shpirtërat e të pranishmëve. . . Njerëzit duartrokisnin dhe betoheshin të rroknin armët përkrah Garibaldit që po zbarkonte atëhere në Marsalë për të çliruar atdheun dhe gratë qanin të prekura nga ajo skenë krejt e re. Të gjithë të ndezur nga fjalët e oratorit të mënçur rendnin në radhët e patriotëve. Edhe gratë deshën t'u vinin pas burrave dhe djemvet në provën e vështirë të luftës; po i ndaluan dhe u desh mund i madh për t'i larguar nga kjo nisjativë ushtarake».

Burrat të komprometuar në këtë ngjarje bashkë me Vinçenc Stratigonë morën arratinë. Pyjet e dëndura me gështenja për rreth fshatit Ungër u bënë qëndra për të fshehur «firarët». Shumë gra të fshatit kryen akte heroizmi për të fshehur të ikurit nga autoritetet, të cilët, për të marrë hak kundra kryengritësve të arratisur, arrestuan dhe burgosën anëtarët e familjeve të pafajshme, në mes të cilëve edhe të dy vëllezërit e poetit tonë. U arrestuan shumë gra si dhe e ëma e Vinçenc Stratigoit, Matilde Mantole, e cila i shkruan kështu të birit të arratisur maleve nga burgu i Ungrës: «Unë jam në burgun e Ungrës bashkë me gratë e tjera; t'ët vëllezër gëzojnë e këndojnë në burgun e Kosenxës bashkë me të vëllezërit e Axhasila Milanit».

Në këto rrethana koka e poetit të arratisur ishte vënë në mezat për 2000 dukatë nga autoritetet burbone.

Dhe një vit më vonë, në korrikun e 1860, kur armët e Garibaldit po triumfonin në Siqili dhe në Kalabri dhe, kur komiteti revolucionar i Kosenxës urdhëroi mobilizimin e përgjithshëm, në Ungër, të nxitur nga fjala e poetit, dollën 500 luftëtarë vullnetarë, që po aty në mbledhje u ndanë në pesë kompani, drejtimin e njerës nga të cilat e pati Vinçenc Stratigoit, duke qënë edhe komisar politik i këtij formacioni. Pas fitoreve të rru-feshme të Garibaldit në Kalabri, si në Siqili, Stratigoit bashkë me shumë krerë të tjerë arbëreshë, ndjekin këmba këmbës armikun gjer në Napoli. Dhe, kur forcat çlirimtare garibaldine shëmbën regjimin e urryer të burbonëve dhe hynë triumfalisht në këtë qytet, një ndër garibaldinët më të zjarrtë të Ungrës, oratori i shquar dhe poeti luftëtar, Vinçenc Stratigo, me fjalimet e tija nëpër sheshet e Napolit i tregoi popullit udhën e Romës që edhe për disa kohë mbeti nën pushtetin e Papës. Garibaldin i flaktë për një republikë të bashkuar me të gjithë italianët, nuk e koncepton Italinë e çliruar dhe të bashkuar pa Romën kryeqytet. Si del nga shumë shkrime të tija, Vinçenc Stratigoit bëri një luftë të ashpër kundra neoguelfizmit, që kërkonte një Itali të bashkuar me Papën në krye.

Çlirimi dhe bashkimi i Italisë më 1860 u arrit nga poshtë, nëpërmjet revolucionit, në saje të luftës me vetmohim të masave popullore. Por frytet e tyre i grabitën aristokracia feudale e borgjezuar dhe borgjezia e madhe me në krye dinastinë e Savojës. Politikanët reaksionarë me Kavurin në krye përfituan nga dobësia e krahut republikan demokratik dhe nga mosdashja e republikanëve të lidhin lëvizjen nacional-çlirimtare me revolucionin fshatar.

Pas fitores kundra regjimit të Burbonëve, kur Garibaldi i dorëzoi mbretërin' e Napolit Viktor Emanuelit, me kërkesën e heroit të Nicës, shumë oficerë garibaldinë, të emëruar gjatë luftës çlirimtare popullore, u inkuadruan me gradat që kishin fituar gjatë luftës garibaldine në ushtrin'

e rregullt kombëtare. Sikurse edhe të tjerët edhe kapiteni Vincenc Stratigo mbeti në ushtri dhe si i tillë, pati edhe poste me rëndësi gjer më 1867. Më 1866 ai u bë edhe shef i shtatmadhorisë me gjeneral Durandon.

Po oficerët e karrierës, sidomos ata me origjinë nga Piemonti dhe Italia e Veriut, që kishin mbaruar kolegje dhe akademira ushtarake, kurrë nuk i shikuan me sy të mirë oficerët garibaldinë, që kishin dalë nga zjarri i luftavet garibaldine. Një ditë, duke ngrënë bukë, një oficer savuarad i karrierës e fyu rëndë Vinçenc Stratigonë. I prekur në sedër, ky menjëherë rrëmben piatën që kishte përpara dhe ia hodhi turinjëvet oficerit mburavec dhe dha dorëheqjen.

Më 1867 poeti ynë u kthye në Ungër, ku, si na e thotë vetë, u muar me punë bujqësore dhe me shkrime, shqip e italisht, po sidomos italisht, kur po përgatit veprën e tij ekonomiko-shoqërore «Gjeografia Ekonomike» që ia seksuestruan autoritetet të pambaruar dhe nuk ia kthyen më kurrë.

Shteti që u krijua në Itali pas çlirimit qe shtet i borgjezisë së pasur dhe i çifligarëve latifondistë. Pas bashkimit Italia hyri në rrugën e zhvillimit relativisht të shpejtë kapitalist: u krye procesi i formimit të tregut kombëtar, u hodhën themelet e industrisë së rëndë, marin hov të madh degët e tjera të industrisë. Në qoftë se Italia e Veriut bën çmos për t'u forcuar nga ana ekonomike, në Jugë vazhdojnë t'ekzistojnë marrëdhëniet e prapambetura feudale; fshatarët s'kishin tokë dhe shfrytëzoheshin si në mesjetë. E rëndë ishte sidomos gjendja e fshatarëve të Kalabrisë, Siqilisë dhe në përgjithësi Italisë së Jugut, ku ishin ruajtur të paprekura të drejtat feudale mbi tokën. Këto krahina të prapambetura u kthyen në koloni të Italisë së Veriut: burim për lëndë të parë dhe treg për shitjen e mallrave industriale. Për popullin punonjës, fshatarët, punëtorët, bujqit dhe shtresat mikroborgjeze, vijoi shtypja nën format e vjetra, trashëgim jo vetëm i kohëve të feudalizmit, por edhe të kohëve më të vjetra, të cilave i u shtua një sistem fiskal kaq i egër, që nuk pat zbatuar asnjë regjim borgjez në vendet e tjera. Masat popullore ishin të pakënaqura nga taksat e rënda, që u mirreshin për të krijuar një ushtri të madhe dhe një flotë të fuqishme, nga korupcionet dhe çrregullimet që ishin gjëra të ditës në pushtetin e ri, nga nepunësit që emëroheshin pa provime, me rekomandime dhe që ngriheshin në grada me anën e favoreve, nga ligjet që nuk aplikoheshin. Pakënaqësia u shtua me shërbimin ushtarak të detyruar, me rritjen e vazhduar të taksave të reja; shumë e urryer qe taksa e ujemit të mullirit. Varfëria ishte e madhe gjithandej, sidomos në jugë e pra edhe në Kalabrin' e Vinçenc Stratigoit. Toka e pakët i hapi rrugën emigrimit të fshatarëve të jugut, të këtyre të skamurve që siç shkruante Lenini, i dëbonte nga dheu i tyre uria me kuptimin e plotë të fjalës. Dikush shkruante në atë kohë: «Fshatari më i pasur i tokës në Italinë e lirë është i detyruar sot e kësaj dite nga mjerimi që të vejë e të gjuajë bretkoca». Dhe bashkë me varfërin' e madhe ishte edhe padija: 17 milionë analfabetë.

Në Italinë e Jugut, Basilikatë dhe Kalabri, kolera bënte kërdrinë. Klasa drejtuese italiane me ligje të sanksionuara u a hoqi të drejtën e votës pjesës më të madhe të popullit, që nuk kishin e nuk dinin, duke vënë një censurë aqë të lartë, sa në një popullsi prej 27 milionësh vetëm 530 mijë arrinin shumën e nevojëshme për t'u shkruar në listat elektorale. Më 1870 zgjedhësit në të gjithë Italinë përbënin 2% të popullsisë. Kurse më 1850 përqindja u rrit në 2,18. Veç kësaj u bënë edhe kufizi-

me të tjera. Reforma elektorale e vitit 1882 e shtriu të drejtën e votës mbi 2 milionë qytetarë, po me që i përjashtonte analfabetët dhe ata që nuk kishin të paguanin cenzen, numri i zgjedhësve nuk ishte i barabartë në të gjitha krahinat e Italisë. Kështu në Piemont ishte shkruar në listat elektorale gjysma e popullsisë mashkull, kurse në Siceli gati një e pesta dhe në Kalabri akoma më pak. Frekuentimi shkollor i detyruar për fëmijë nga 6 gjer më 9 vjeç mbeti në letër për komunet e varfëra, sidomos për komunet malore, të cilët nuk ishin në gjëndje t'a zbatonin sepse u mungonin fondet dhe ndërtesat shkollore.

Jetën politike e shoqërore të vendit e karakterizonin abuzimet dhe shpërdorimet e nëpunësve, arbitrariteti dhe marrja nëpër këmbë e të drejtave të qytetarëve, demagogjia dhe mashtrimet pa shkrupull.

Në kohën e zgjedhjeve partitë dhe grupet politike, përdornin në shkallë të gjerë korupsionin, duke shikuar seicili interesat lokale, duke u bashkuar me krerët që shikonin interesat personale dhe ambicjet e tyre. Republikanët e pakët të së mëngjërës ekstreme, me të cilët është poeti ynë, nuk përbënin një forcë të zonjën për të vepruar në opozitë. Një grup republikanësh, të papajtuar me monarkinë, qysh më 1873, kishin krijuar një grup dhe i kundërshtuan Viktor Emanuelit të drejtën që të përfaqësonte Italinë, po më 3 gusht të atij viti u arrestuan në Vila Rufi, afër Rimitit. Të paktët republikanë që kishin mbetur tani më 1882 krijuan Vëllezërit artizhanë, duke kujtuar të vazhdonin kështu rrugën e Macinit kundra «fronit» dhe «altarit», por kjo ishte utopike dhe pa perspektivë.

Kështu epoka e ndritur e «Risorghimentos» kishte përfunduar dhe po dilnin njerës të rinj, pa shkrupull, që shikonin interesat e tyre personale. Në kohë të zgjedhjeve prefekturat transformoheshin në axhensi elektorale. Korupsioni i qeverisë dukej sheshit: shitje e blerje votash, premtime përfitimesh, frikësimet ndaj zgjedhësve.

Të gjithë prisnin përmirësime, kurse regjimi i ri solli mjerime e varfëri, shtypje të re dhe arbitraritet, ashtu siç do të thotë Vinçenc Stratigo më 1874 «si stava meglio, quando si stava peggio».

Poeti e denoncoi ashpër thelbin antipopullor dhe thellësisht reaksionar të sistemit politik dhe shoqëror që u vendos në Itali pas bashkimit dhe stigmatizoi me zëmërim klasat e larta, që tradhëtuan masat popullore, me gjakun e të cilave u sigurua çlirimi e bashkimi i vendit.

Qëndrimin e vet ndaj problemeve politike, ekonomike dhe shoqërore të ngutëshme të kohës ai e shprehu në një varg artikujsh, relacionesh e fjalimesh, të shkruar në italisht, nga të cilat ka mbetur vetëm një pjesë.

Më 1882 V. Stratigo botoi një relacion drejtuar zgjedhësve të kolegjit të dytë të Kozencës, ku ai ishte kandidat. Në këtë shkrim, si armik i taksave dhe shpenzimeve që nuk prodhojnë, trajton çështjen e dizekuilibrit në mes të shkëmbimit dhe të prodhimit dhe kërkon zhvillimin dhe ngritjen e bujqësisë si edhe uljen e taksave ndërmarrjeve të vogla bujqësore dhe tregëtare. Bujqësinë e quan burim të përparimit dhe të mirëqënies: «Kombet tregëtare si Egjypti, Greqia, Franca, Kartagjena, Roma, Spanja, Anglia, Venediku patën sundimin e tregëtisë ndërkombëtare dhe, për të ruajtur përparimin e tyre, qenë të detyruar që të bëheshin vende bujqësore, duke e bërë bujqësinë burim kryesor të jetës private dhe politike, forcën e shteteve të tyre, kurse tek ne për fat të keq tregëtia është e pakët dhe e rënduar me taksa, bujqësia e lënë pas dore, ajo e pakët që nxirret nga toka, përpiket nga shteti: Ja dizikuilibri».

Çështja shoqërore dhe sidomos çështja e prapambetjes së krahinave

të jugut bëhet tanimë pasioni i vetëm i Stratigoit, si studjonjës e si poet. Në këtë shkrim autori prek çështje të aspektit ekonomik dhe kultural. «Njeriu duhet të ushqehet — shkruan ai — pastaj të mësohet, të edukohet, të bëhet më i mirë, të perfeksionohet në mendje dhe në zemër dhe pastaj të transportohet nga një vënd në tjetrin. Ne thërresim për një barazim trajtimi. . .»

Poeti, si u largua nga jeta politike dhe u vendos në Ungër pas diziluzioneve që pati, në kontakt me klasat e varfëra të Kalabrisë, e ndjeu varfërinë e tyre, përqafoi kauzën e asaj krahine të braktisur dhe e mbrojti gjithënjë me kurajo. Në relacionin «Dizikuilibër në mes të shkëmbimit dhe të prodhimit» në mes të të tjerave shkruan: «Ne, pas kaqë zhgënjimesh, pas kaqë gjaku të derdhur prej burrash me karakter dhe patriotizmi të humbur më kot, kemi të drejtë të na dëgjojnë; ne duam që universitetet e Italisë të pushojnë së qëni privilegj dhe libër i mbyllur për mendjet e ndritura të qytetarëvet fusharakë, që banojnë larg qëndravet të mëdha. Pajtojeni mësimin me ushqimin, këto dy motra binjake, shoqe të pandara që përqafohen e shtrëngohen dhe kanë të drejtë të jetojnë dhe të zënë vendin që u përket në qerren e madhe të shoqërisë». Po këtu ai shkroi me kurajo të veçantë kundra institucionevet të vjetra, që janë çdukur de jure, po jo de fakto: «Disa institucione të vjetra janë zhdukur de jure po jo de fakto. Latifondet, pjellë e qeverisë aristokratike të Romës, feudet, pjellë e sundimit ushtarak barbar, jetojnë edhe ndër ne, përparojnë e lulëzojnë dhe ne po i shijojmë frutet e tyre, sikur të mos kishte marrë fund mbretëria e markezineve flokëverdha dhe të kalorësve të rreptë».

Kështu V. Stratigoi, si njeri, si poet e si studjonjës i çështjevet shoqërore të vëndevet të jugut meriton të numërohet në mes të mbrojtësve të mëdhenj e më të guximshëm të të drejtave të atyre krahinave, gjithënjë të braktisura, që klasat reaksionare sundonjëse i mbajnë edhe sot e kësaj dite në mes të varfërisë dhe errësirës.

Më 1 shtator 1874 Stratigoit iu rrethua shtëpia dhe iu rekuizuan shumë shkrime, në mes të të cilavet edhe traktati politiko-ekonomik «Gjeografia politiko-ekonomike». I zëmëruar nga ky akt arbitrar poeti rroku pendën dhe shkroi një protestë të ashpër me titull *Protestë për V. Stratigonë* ku i akuzoi autoritetet për aktet arbitrare dhe për shkelje të ligjeve. Ky relacion ka rëndësi sepse lëshon dritë jo vetëm rreth biografisë së Stratigoit në vitet e fundit të jetës, por është një dokument me interes rreth qëndrimit të gjithë arbëreshëvet që kishin marrë pjesë në luftën e çlirimit dhe të bashkimit të Italisë dhe që u tërhoqën nga skena politike pas formimit të monarkisë, të diziluzionuar nga regjimi politik që u vendos. Në këtë protestë poeti, pasi tregon për veprimtarinë e tij revolucionare që e kishte nisur qysh kur ishte 22 vjeç, duke sakrifikuar çdo gjë për çështjen e çlirimit të masave popullore, shpreh habinë për sjelljen arbitrare dhe rekuizimet që i bënë në shtëpinë e tij. «Si konspirova pothuajse që më '44 për të bërë të vërtetë ëndërrën e Dantes, Makjavelit, Viktor Alfierit, Leopardit dhe Xhuzepe Macinit, krijonjës të forcës morale të popullit italian, si vajta e u bëra ushtar i lirisë më 1848, me Gjeneral Ribotin, më 1860 nën gjeneral Garibaldin, më 1859 si i fola popullit të Lungros ditën e 16 korrikut për demonstratën që shpalli pavarësin' e Italisë, fjalë që bëri të zvarrisen nëpër burgjet e qytetit të Kosenxës gjithë ata djelmossa të zjarrtë, me gjithë dy vëllezërit e mij dhe nënën time shtatëdhjetvjeçare, si i fola popullit më 1860 në sheshin e Shën Franceskut në Napoli, duke i treguar atij rrugën e Romës kundra diktatorit, markezit

Palaviçini, që si duke bubulluar lëshonte vetëtima kundra profetit të së ardhshmes. . . si u shpalla njeri me merita të atdheut ditën e 20 qershorit 1869 nga princi i Savojës. . . si bëra betimin, megjithëse qytetar i lirë, për besnikëri ndaj mbretit, ndaj atdheut dhe ligjit themelor të shtetit, kush do të kishte mundur vallë të besonte që, pas gati dhjetë vjet jetë të veçuar dhe të vetmuar do të kisha fatin të nderohesha me një vizitë perkuizimi?»

Pas kësaj auktori tregon se si më 1 shtator 1874, njerëz të autoriteteve të vendit, që ai në fillim i mer si miq, i bëjnë një kontroll të rreptë. Kur e kupton të vërtetën e pasi e merr vehten, duke menduar tek e kaluara e tij, thërret me habi:

«Sa mora vehten, më shkoi ky mendim nëpër tru: «Mos ka kthyer vallë prapë Francesku i II-të?». Pastaj me ironinë e tij të zakonëshme, na rrëfen se si karabinierët kërkuan kot për «pushkë e për topa» dhe u kthyen me duar bosh.

Kjo protestë është një shëmbull guximi të rrallë përpara njerëzve të drejtësisë. Kur gjykatësi hetues e pyet autorin në se ato shkrime janë të tijat dhe i thotë se aty duhet vënë nënshkrimi, ai i përgjigjet me kurajo:

«U bë e mundur një kohë që me tortura të vazhduara të mohohesh lëvizja e tokës përpara gjykatësve inkuizitorë, po unë, bashkëqytetar i Xhiordano Brunos nuk mundem, s'dua, as nuk duhet të mohoj frutin e punës sime, pa mohuar të kaluarën time dhe pa tradhëtuar ndërgegjejen time. Po përse vallë i sekuestroni këto shkrime?», dhe vazhdon: «Veproni dhe kryeni kundra meje çdo veprim të vullnetit tuaj, sepse frikën e lashë në bark të nënës, që ditën kur linda. . . Veçse dijeni se pas tridhjetë vjetësh të turbullt, në mes shgënjimesh të thyera, në mes shpresash të gënjyera, në mes revolucionesh të tradhëtuarra dhe fatkeqësish shoqërore, unë di t'i dalloj mirë të drejtat e pushtetit nga ato të lirisë».

Me një stil të fuqishëm oratorik, autori mbrohet, duke demaskuar qeverinë për ndërhyrje dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve: «Ndërkaqë shkrimet e mia u sekuestruan dhe nuk m'u kthyen. Shkrime, që janë pjesë po e përsëris, të një veprës sime, shkrime që nuk përmbajnë dëshira shkatërrimi dhe fyerje kundra shtetit, s'janë propozime reformash politike, s'janë nxitje për kryengritje, po dëshira reformash administrative dhe financiare, dëshira ekuilibri në mes të interesave të thesarit të shtetit dhe atyreve të komunes dhe të provincës; si rrjedhim shkrimet e mia në asnjë raport nuk mund të jenë shkak për efekte penale, pa kryer një akt padrejtësie të madhe dhe njëkohësisht pa ngatërruar efektin me shkakun, aktin me fuqinë, faktin me qëllimin. Me gjithë këtë drejtonjësit tanë, si të luajtur menç, të pushtuar nga një frikë e pathemeltë, mundohen me këmbë e me duar dhe me të gjithë pushtetin, që kanë shtrënguar në grusht, të shkelin banesën, lirinë personale të qytetarëve të ndershëm dhe të sprovuar. Ata mundohen të mbulojnë pastërtinë e emrit të tyre, t'i diskreditojnë pranë opinionit publik, t'i regjistrojnë ndoshta edhe në listën e të qortuarvet, si në kohët e republikës së Firences. . . A mundet vallë të quhet krim baruti i mbyllur me revolver, para se të plasë e shtëna në kohë dhe në hapësirë, dhe para se të shtrihet për dhë i vdekur një njeri? Kush do të mund ta quante vallë fajtor atë që u mësua qysh në qumështin e nënës, në vatrën e thjeshtë të prindërvet të vet që të mos i përulet kurrë vicit të artë, që të mos e përulë shtyllën e kurizit përpara kapadainjëvet mburavecë, që më shikojnë plot krenari. . . Kush mund ta quante fajtor atë që nuk ka tjetër program veç së vërtetës, që s'ka tjetër predikim, besim politik, veç drejtësisë, duke përbuzur duartrokitje dhe duke qëndruar gjithënjë.

Si kala e patundur që nuk i shëmbet  
Kurrë maja nga erërat që fryejnë».

Pastaj, me burrëri të admirueshme, autori shpall hapur se nuk është me qeverinë, sepse ajo sundon me metodat mesjetare: «Unë jam një nga ata shumë të egrit që përshkruan Taciti. . po nuk jam klerikal, sepse nuk predikoj luftën e katolikut të jugut kundra shizmatikut të veriut, nuk konspiroj për të restauruar absolutizmin autokratik në vend të papatit të vdekur. Unë nuk po e vras lirinë, dijen, përparimin njerëzor, po jetoj dhe vdes i varfër, mbrojtës kryelartë i natyrës dhe i njerëzimit. Unë nuk jam me qeverinë jo, sepse kabineti Mingeti është i padenjë për besimin tim, sepse ai e ka vënë Italinë drejt kohëvet të lumtura të mesjetës dhe jo në rrugën e njerëzimit».

Duke u treguar kundra pushtetit në fuqi, ai kërkon një qeveri që t'i shikojë ndryshe interesat kombëtare: «Më 1860, Macini, kur e dëbuan nga Napoli, tha: — As mohues (apostat), as kryengritës (ribelle)». Edhe unë me guximin e së vërtetës, të së drejtës dhe të ndershmërisë, do t'i përsëris fjalët e larta të atij biri të Viktor Alfierit, të atij ati të ringjalljes italiane, të atij mësonjësi të shënjtë: «As mohues, as kryengritës». Viktor Emanueli, kur u hap parlamenti, tha: «Italia u bë, po jo e plotë». Edhe unë do të them: «Viktor Emanueli, Kavuri, Macini, Garibaldi, Napoloni i III-të, Bismarku, kanë qënë krijonjësit e gjeografisë sonë jo të plotë, ajo do të plotësohet mirë jo me vajin e gurit të luftës civile, po me pajtimin harmonik të demokracisë, me një pushtet të ri e të vërtetë, ekzekutonjës të një politike jo të zhburrëruar, po kombëtare, ku do të zërë vend madhështia, përparimi dhe fama kombëtare.

Armik tashti i shoqërivet të fshehta, që ishin të nevojëshme përpara në kushtet e luftës së armatosur për çlirimin kombëtar ku ka marrë pjesë edhe vetë, ai e shpall vehten një internacionalist të moderuar; është për përmbysjen e së vjetrës po jo me mjete violente.

Me shprehje të ashpra e gjithë sarkazëm ai demaskon politikën ekonomike dhe financiare të qeverisë, e cila synonte jo zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe ngritjen e mirëqënies së përgjithshme, por për të shtuar spiunët. «Ky është koncepti im që s'ka të bëjë me pensionet e krijuara dhe të nxjerrura nga fondet sekrete për të majur qesetë e katërqind spiunëvet, që venë duke kurvëruar nëpër qytetet e Italisë me paratë e atdheut». Në fund auktori e këshillon qeverinë që ta drejtojë vendin drejt zhvillimit të bujqësisë, të cilën e quan burim pasurimi të vendit.

Kjo protestë, si të thuash, është një farë programi politiko-ekonomik i Stratigoit, i cili kërkonte që qeveria të ndjekë rrugën e përparimit dhe zhvillimit të vendit duke ndaluar emigracionin; si demokrat dhe revolucionar i vendosur ai parashtrroi nevojën e zbatimit të reformave rrënjësore në favor të klasave të varfëra.

Me këtë broshurë dhe me shkrime të tjera kaqë të avancuara për kohën, Vincenc Stratigo mund të konsiderohet si një nga pionierët e lëvizjes socialiste në Italinë e Jugut. Duket se ai njeh filosofët gjermanë materialistë si Marksini dhe Engelsin, kur thotë: «Le të bërtasin sa të duan ata që thonë se përparimi pa caqe është një jermi, se kjo qëndron në trurin e disa filozofëve gjermanë dhe në fantazin' e poetit që këndon:

Guri i madh u hodh dhe ndërtesa  
E plotë do të ngrihet, gjithçka është në favor».

Në këto rrjeshta nuk mund të mos vëmë re optimizmin e Stratigoit i cili qëndron i patrembur në besimin e vet se e ardhmja është me popujt kundra tiranëve, me masat punonjëse kundra klasave parazitare, çifligarëve mesjetarë dhe priftërinjve.

Autori si gjithënjë edhe në këtë broshurë tregohet republikan dhe antiklerikal i bindur, kur demaskon qeveritë që ndjekin dhe shtypin republikanët dhe favorizojnë klerikët, duke zbatuar politikën «duar lëshuar për priftërinjtë, hekurat republikanëve».

Megjithëkëtë protestë të fuqishme, shkrimet e tija nuk u kthyen dhe është një mëkatë që ato humbën përgjithmonë.

Më 15 maj 1881 V. Stratigo i dërgoi një letër shoqatës popullore kulturele të Kozencës, e cila e kishte ftuar që të merrte pjesë në një meeting në atë qytet. Kjo letër është një dokument i rëndësishëm për idetë e Vinçenc Stratigoit, sepse ai del që më 1881 si prekursor i kërkesës së votës së përgjithshme, duke dashur kështu të demokratizojnë parlamentin dhe të tërheqë të gjitha shtresat shoqërore që të marrin pjesë në skenën e jetës politike të vendit.

Si kërkon të falura, *se për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij* ai nuk mund të marrë pjesë në atë mbledhje, u thotë bashkëqytetarëve: «Është e nevojshme që të rivendikohet parimi i sovranitetit popullor. . . që e kanë kërkuar një mijë metigje, që kanë vetëdijen se s'janë krymba të kësaj toke, po arbitër sovranë të fatevet të tyre». Ai kërkon që me votimin e përgjithshëm të emancipojë «milionat e ilotëvet nga monopoli i të dymbëdhjetë a njëzet vetavet, të cilët nga 1860 e këtej, s'kanë bërë tjetër veçse ta kthejnë këtë tokë shumë prodhonyesë të Saturnit në një vend të shkretë emigrantësh dhe martirësh. (fjalën e ka për Kalabrinë — Z.K.) Për ne, o qytetarë, votimi i përgjithshëm nuk është thikë që përgjak dheun, po është degë ulliri, simbol paqe, dashurie, vëllezërimi shoqëror. . . është e drejta universale, që nuk lindi dje, as do të vdesë nesër, por është mëndja e Jupiterit e stamposur në zemër të njeriut dhe të qytetarit, është unaza fatidike e pandryshuar e dasmës, që ra ca kohë përpara në tabakanë e popullit mbret, unazë, që duke shkëlqyer përpara syvet të habitur të Italisë së shkretë, dashka s'dashka plutokracia, do të zbukurojë gishtin e popullit italian, vëlla, që jeton, mendon, vuan». Si shihet autori është me popullin, kundra plutokracisë. Më poshtë ai do ta tregojë më hapur këtë lidhje dhe simpati për vegjëlinë, për shtresat e ulta të shoqërisë, duke kërkuar të drejtën e votës për të gjithë, si për ata që kanë ashtu edhe për ata që s'kanë. «Ne bashkëqytetarë të Alfierit, të Foskolos dhe të Xhuzepe Macinit, duam. . . që e drejta elektorale t'u epet të gjithë atyreve që kanë e që dinë dhe të gjithë atyreve që nuk kanë dhe që nuk dinë. Poshtë privilegji, shatore e Nabukos, rroftë barazimi i kuptuar mirë, shpirt dhe jetë e botës».

Më poshtë autori ngre lart rolin e masave popullore për çlirimin e Italisë nga zgjedha dhe për bashkimin kombëtar. «Më kot Dante dhe Xhuzepe Macini, Viktor Emanueli dhe Xhuzepe Garibaldi do ta kishin bërë Italinë pa vegjëlinë, vegjëlinë që është pjesa më e dashur, më e shënjtë, më e merituar e kombit. Vegjelia e bëri dhe do ta plotësojë Italinë, vegjelia do ta bëjë dhe do ta plotësojë parlamentin e ri, jo aristokratik, krahinor, po italian që të përfaqësojë nevojat, aspiratat, dëshirat të të gjitha klasave shoqërore». Këtë meritë të madhe të popullit të thjeshtë në luftën e çlirimit dhe të bashkimit të Italisë, autori do ta tregojë më bukur në mënyrë poetike në poezinë e tij të shquar «Merori», ku është paraqitur figura e ushtarit të popullit, që sakrifikoi çdo gjë për të mirën e vendit.

Për të zgjidhur problemet që e mundojnë vendin, poeti kërkon që të vijë në fuqi vegjësia. «Atëhere të thërritet në ushtrimin e të drejtës politike vegjësia e merituar... vegjësia, ushtar trim e guximtar i detyrës së vet, ajo do të ishte ruajtës shumë i kujdesëshëm i atdheut, armë e tmerrshme kundra të gjithë armiqtë të bashkimit të Italisë».

Pastaj autori zbulon thelbin reaksionar të reformës reaksionare që po përgatitej nga klasat sunduese për të kufizuar të drejtat e vegjësive. V. Stratigo i kundërshtoi këtë orvatje dhe ngul këmbë në pjesëmarrjen e gjerë të masave popullore në zgjedhje dhe thotë se ajo reformë është përgatitur në favor të shfrytëzuesve, si gjithënjë: «Po kjo a nuk është një e metë që shtyn shumicën e komisionit që ta bëjë shumicën e popullsisë kombëtare ta ulë kokën nën cfurqet kaudine të pak të privilegjuarvet, që vjelin dhe shfrytëzojnë vreshtën italiane të mbjellur dhe të punuar nga populli profan?»

Në këtë letër V. Stratigo i del me kërkesën shumë të avancuar për atë kohë, që në zgjedhjet t'i ipej e drejta elektorale edhe gruas:

«E drejta e votimit t'u epet jo vetëm analfabetëve dhe masave të gjera popullore, po edhe gruas, e cila ka të drejtë të jetë qytetare si mashkulli».

Në këtë letër gjejmë edhe iluzionet mikroborgjeze të Stratigoit, i cili me gjithë urrejtjen e madhe që ushqen për të pasurit dhe të fuqishmit, nuk arrin të kuptojë se pa shembur sistemin e padrejtë shoqëror, nuk mund të shpëtojë vegjësia nga shtypja dhe shfrytëzimi i egër. Me naivitete të madh beson se nëpërmjet realizimit të së drejtës elektorale të përgjithshme mund të arrihet çlirimi i të shtypurve dhe të zgjidhen kontradiktat në mes të të varfërve dhe të pasurve.

Në dokumentat e rëndësishme që na ra në dorë kohët e fundit, është fjalimi që V. Stratigo mbajti me rastin e vdekjes së Xh. Garibaldit, më 2 qershor 1882.

Fjalimi nis me kontributin që kanë dhënë ungriotët në luftën e bashkimit dhe të çlirimit të Italisë më 1848 dhe më 1860 me të 500 luftëtarët vullnetarë garibaldinë. Autori e quan me krenari vehten dhe bashkëfshatarët e vet pellazgë dhe Garibaldin degë të trungut pellazgjik, duke thënë: «Unë ju them ne si pellazgë kemi të drejtë të kremtojnë apoteozën e Garibaldit, i cili është një degë e lumnueshme e trungut të madh pellazgjik, ai është jeta e jetës sonë, raca e racës sonë, gjaku i gjakut tonë».

Me një sintezë të çuditëshme oratori tregon veprimet luftarake të Garibaldit për çlirimin e popullit italian dhe të popujve të tjerë.

«Garibaldi — thotë poeti — është ribelion i së kaluarës, fitore e së tashmës, besim në të ardhshmen. Trinitet i Pitagorës, i Dantes, i Vikos, i Xhuzepe Poerit, i Macinit të vënë në veprim... Fe pa Papën, atdhe pa Sinjori». Stratigo thekson altruizmin dhe heroizmin e Garibaldit, qëllimin humanitar të luftave të tija. «Garibaldi nuk është Patriarka që sakrifikon njeriun mbi altar të Perëndisë, krijon familjen... Garibaldi sakrifikon vehten për familjen, familjen për atdheun dhe atdheun për njerëzimin. Ai nuk është Mozeu që krijon shoqërinë kombëtare mbi egoizmin, mbi urrejtjen, mbi hakmarrjen; Garibaldi e ngren bashkimin e Italisë, duke propaganduar dashurinë dhe faljen».

Stratigo nga fundi e përshëndet Garibaldin si një Cincinat të ri: «Përshëndetje, o kreshnik i familjes, ti, Cincinat i ri, ti i mësove botës se në kohë paqe kreshniku i vërtetë, e ul shpatën e luftës dhe rrëmben parmendën e bujkut». Me këtë oratori vret tek fakti se Garibaldi, si çliroi krahinat e Jugut dhe Romën, ia dorëzoi pushtetin Shtëpisë Savoja

dhe vetë u tërhoq në jetën e njeriut të thjeshtë. Ky qe një gabim i madh i Garibaldit, që edhe Stratigoi e pranon.

☛ Përveç këtyre shkrimeve, Stratigoi ka lënë edhe dy shkrime me përmbajtje patriotike: «*Proklamata shqiptare e 1848-ës*» dhe «*Thirrje shqiptare: stërgjyshërve të mij*».

Ne veprën e parë, të cilën e njohim në fragmente, Stratigoi u drejtëhet arbëreshëve si stërnipër të Skënderbeut dhe me një stil oratorik të fuqishëm i nxit të rrokin armët kundra burbonëve. Poeti e ftoh hijën e Kastriotit të jetë pranë bijve të tij arbëreshë: «Ngrehu, ngrehu nga varri, o i famshmi Skënderbe, ngrehu dhe ec e sodit stërnipërit e tu, që kanë ngritur ballin lart kundra tiranit të Napolit, i cili i shtypte me këmbë si baltë dhe i tërhiqte zvarrë në kasapanë si qingja».

Edhe «*Thirrja shqiptare*» na ka arritur në disa fragmente, që i ruan i biri, Angelo Stratigo. Kjo është një vepër letrare—publiçistike. Fantazia e shpie poetin në dheun e të parëve, stërgjyshërve të vet, të cilët i kujton me mall, duke sjellë në mend fitoret e tyre në luftë kundra turqëve. Shkrimi nis me një thirrje enfatike, ku evokohen trimëritë e shqiptarëve në betejat e zhvilluara me otomanët: «O flamur i epirotëve! O betejat e fituara për liri, o fitoret e lashta! O varre! O kuaj! O hije, që dridheni të stërgjyshërve të mij! Ku jeni vallë tani? O s'po e dëgjoni, se kush u thërrret nga larg?» Kështu kjo thirrje, e cila nis me këtë evokim e shpije poetin në tokën e të parëve për të ekzaltuar trimëritë e tyre të pavdekëshme.

\* \* \*

Vinçenc Stratigoi nuk qe vetëm luftëtar i flaktë për lirinë dhe mi-rëqënien e vegjëlisë, orator dhe publiçist i apasionuar, por edhe figurë e shquar e letërsisë arbëreshe. Ai la një tok vjershash, të cilat përfaqësojnë interes të veçantë sepse me to hynë në letërsinë shqipe idetë socialiste: «Proletari», «Merori» (bersalieri) «Katundarët e Rusisë» dhe oda patriotike në italisht «Shqiptari».

Ndër poezitë në italisht që shkroi, pa asnjë dyshim, më e bukura është ajo me titullin «Shqiptari». U shkrua më 1857 dhe ka trajtën e një ode klasike. Pa u botuar, para 1962, ajo qarkulloi në dorëshkrim dhe u mësua përmënc nga fshatarët arbëreshë të fshatravet të Kalabrisë, duke ngjallur tek ata entuziazëm të madh dhe krenari për atdheun e Skënderbeut, nga i cili rridhnin dhe për të cilin s'e humbën kurrë kujtimin dhe dashurinë. Kjo poezi, e shkathët, e fuqishme dhe e lartë, për përmbajtjen patriotike shoqërore, për vrullin dhe për forcën revolucionare që e përshkon, nuk e ka shopen në të gjithë poezinë arbëreshe të shek. XIX. Ajo është me të vërtetë një poezi e frymëzuar, që poetit i ka buruar nga shpirti, dokument i fortë që dëshmon për dashurinë për liri dhe urrejtjen që ushqente kundër tiranisë; ajo është një poezi e frymëzuar, me thekse sublime. Vjersha e ka burimin tek letërsia përparimtare e klasiçizmit të Ugo Foskolos, Vitorio Alfierit e Jan Batista Nikolinit nga një anë dhe, nga ana tjetër, tek poezia e romantizmit përparimtar, e Xhuvani Bershesë, Xhuzepe Xhustit, Tomaso Grosit, tek poezia e hymneve revolucionare me andaturë luftarake të Luigj Merkantinit, të Aleksandër Poerit dhe të Gofredo Mamelit. Nga forma dhe nga gjuha ajo është model klasiçizmi, kurse nga përmbajtja është krejt romantike. Në këtë vjershë kemi një shëmbull tipik, ku janë shkrirë, ashtu si në poezinë patriotike përparimtare italiane të shek. XIX, të dy rrymat letrare, klasiçizmi i Foskolos, Alfierit dhe Ni-

kolinit dhe romantizmi luftarak i një radhe të tërë poetësh, ndër kryesorët Mameli, Merkantini, Poeri.

Edhe poetë të tjerë arbëreshë të shek. XIX shkruan poezi patriotike me përmbajtje revolucionare shqip e italisht si Zef Serembe, vargjet e të cilit kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të shkundur edhe për të ndezur thellësisht shpirtërat e arbëreshëve, po asnjera prej tyre nuk e ka fuqinë dhe vrullin revolucionar të vjershës «Shqiptari» të V. Stratigoit, që të rrëmben me gjithë atë vrull marshi që e përshkon. Vjersha «Shqiptari» është një lirikë e fuqishme civile të një madhështie të re. Në krye të kësaj vjershe poeti ka vënë si moto një frazë të bukur të Jan Batista Nikolini (1782-1861): «Atdheu lihet, braktiset, po nuk harrohet». Nikolini qe një autor i dashur për Stratigonë, të cilin e tërhiqnin mendimet e tija antiklerikale, qëndrimi kundërshtar i rreptë ndaj partisë letrare e politike të neoguelfëve, që shpresonin në rigjenerimin e Italisë me Papën në krye. Duket se Nikolini e ka tërhequr poetin tonë, sepse ai, Nikolini, kujdo që i nxirte përpara këtë lëvizje të inaguruar me emrin e Papës, i përgjigjesh i zemëruar: «Me të vdekurit në Santa Croce nuk gabon njeri», duke bërë aluzion me këtë shprehje tek doktrinat politike antipapale të Dantes, Makjavelit, Alfierit e shumë figurave të tjera italiane, eshtrat e të cilëve pushojnë edhe sot e kësaj dite në Santa Croce të Firences. Si Nikolini edhe poeti ynë është një adhuronjës i figurave që përmëndëm më lart dhe e quan vehten shumë herë si nxënës i tyre, që ka dhënë edhe ai kontributin e tij modest për realizimin e ëndërrës së tyre të madhe për çlirimin dhe bashkimin e Italisë.

Nis vjersha me një adagio, ku poeti qysh në fillim do të tregojë me krenari legjitime origjinën e tij prej shqiptari, fatin e shqiptarëve të shpërdarë si zogjtë e korbit në dhe të huaj:

T'rreptë kam shikimin, shpirtin të çiltër,  
Në gjoks me dridhet virtyt luftari,  
Linda, do vdesi për vendin tim,  
Shqiptar unë jam.

Princa t'guximshëm, idhnak' të poshtër  
Ma shprishën gjakun, po jo kurrë zëmrën,  
Në shpirt-o paqën zoti ma derdhi,  
Shqiptar unë jam.

Nga toka nënë t'Epírit t'ëmbël,  
Të mijtë stërgjyshër ikën një ditë,  
Nga vendi dashur duke qar' ikën,  
Shqiptar unë jam.

Poetit i dalin përpara vizione të së kaluarës të shek. XV, Skënderbeu:

Fëmij dëgjova nga t'parët tanë  
T'lashtat kurora t'luftavet tona,  
Zëmrim i shënjtë zemrën ma ndezi,  
Shqiptar unë jam.

Skënderi im në luftë të shënjtë  
Me gjak të turkut tokën vaditi  
Dhe plot fitore në vend u kthye,  
Shqiptar unë jam.

Skënderi im që më vetimë t'syvet  
 Përpara vinte turqit me mijra,  
 Diell' i shkëlqyer i vendit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Poeti u këndon fateve të veta si pinjoll të fisit arbëresh, që ka qëndruar si shkëmb përpara dallgëvet të jetës dhe s'e ka harruar për asnjë çast se është shqiptar:

N'vajttime linda, ndër arm' u rrita,  
 Me tinguj t'këngës përballoj vdekjen,  
 Në luftë do vdesi për vendin tim,  
 Shqiptar unë jam.

Trashëgim tjetër unë nuk pata,  
 Zemër të dridhur, trimëri të madhe,  
 M'tingëllon në buzët një fjalë e ëmbël,  
 Shqiptar unë jam.

Besim i lashtë, dashuri e vendit,  
 Ma ndez mua zemrën, ma ngroh mua gjoksin,  
 Gjaku e derdhi për vendin tim,  
 Shqiptar unë jam.

Vjersha «Shqiptari» është një pasqyrë e gjallë e luftës së dyfishtë që bëjnë arbëreshët: luftë me armë për çlirimin dhe bashkimin e Italisë, dhe lufta për lirinë e dheut të të parëve, sepse arbëreshët luftuan edhe për zgjimin dhe çlirimin e Shqipërisë:

S'kam pasurira, përbuz paranë,  
 Rrëmbej unë shpatën t'Boçarit tim,  
 T'Boçarit nami i vendit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Pas së kaluarës luftarake mesjetare dhe të kohëvet moderne shqiptare, poetit i dalin përpara vende dhe figura arbëreshësh, që i kujtojnë të kaluarën e afërt luftarake të fisit të vet dhe këtu numëron kontributin që kanë dhënë për çlirimin dhe bashkimin e Italisë fshatrat arbëreshe Ungro, Specano, Shën Mitër, kujton figurat arbëreshe që ranë në sheshin e betejës për çlirimin e Italisë më 1848:

N'dyzetetetën me zëmrim të shënjtë,  
 Kur mbreti ligjin-o na e shkeli,  
 Unë rroka armët për vendin tim,  
 Shqiptar unë jam.

Vet unë mbi Kratin, n'kushtrim t'atdheut  
 Vajta dhe ngula flamurin tim,  
 Shkunda dhe trimat e vëndit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Atje, n'Sant' Anxhelo, mbi kodrën rripë  
 Armikut t'mbrapshtë ia prisha gjakun,  
 Kuror fitoi atje fshati tim,  
 Shqiptar unë jam...

Na u ngrit Lungro, u ngrit Specano,  
 Akuaformoza me arm' në duar,  
 Armët rrëmbeu edhe Plataçi,  
 Shqiptar unë jam...

O Kjod. o Toç-o, Mauer kryelartë,  
 Kokën u shtypën, jo kurrë mendimin,  
 O gjak i pastër i vendit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Përpara dhëmbjes së shokëvet të humbur poetit i del përpara e urryer figura e tiranit, që u bë shkaktar i asaj humbje, i dalin përpara veglat e tija:

E ti frikacak, m'dëgjjon e qeshe,  
 Ti që më shkele të gjith' atdheun,  
 Ti je kopil-o i vendit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Ti të atdheut shkele altaret,  
 Atdhen' shpëtoj unë më gjakun tim,  
 Ik se ty zoti, ty të mallkoi,  
 Shqiptar unë jam.

Ti nuk i shtyp dot me fuqin' tënde,  
 Virtytin tim-o, qëndresën time,  
 Linda, do vdesi për vendin tim,  
 Shqiptar unë jam.

Vjersha që nisi me një adagio, që vazhdoi me një kreshendo madhështore, mbaron me një kulminante tirteiane, që është një thirrje e fuqishme për luftë:

Luftoj për t'drejtën, të shënjtën, t'vërtetën,  
 Po dëshiroj ditën t'çlirimit tim,  
 Ngreu, flamur-o, i vendit tim,  
 Shqiptar unë jam.

Kushtrim, kushtrim, i shënjtë zëmrimi,  
 Për fatkeqësinë zoti m'frymzon,  
 Ndër armë, ndër armë, o vendi im,  
 Shqiptar unë jam.

Idenë, se në kujtimin e luftrave trimërore të shqiptarëve në të kaluarën, në të bëmat legjendare të Skënderbeut, poeti gjen frymëzim e ka shprehur edhe Serembe në disa vjersha, po te Stratigoi kjo ide shpërtheu me një forcë patetike e epike të pashoq.

Duke patur parasysh përmbajtjen e të dy vjershave themi me bindje, se ajo e poetit të Strigarit e ka burimin në gurrat e poezisë së Stratigoi.

Ëda «Shqiptari» u shkrua më 1857, kur poeti ynë ishte 35 vjeç dhe sipas thënietve të të birit të poetit, Dr. Anxhelo Stratigo, sot plak 88 vjeç, u shpërnda në dorëshkrim nëpër fshatrat arbëreshe të Kalabrisë, ilegalisht. Më 16 korrik 1859, kur Italia ziente nga revolucioni dhe Garibaldi po pregatitesh të zbriste në Siqili për t'u hedhur q'andej në Kalabri, si ndodhi me të vërtetë, në një meeting të organizuar në një shesh të Ungrës, poeti, pas fjalimit që u mbajti pjesëmarrësve, u lexoi edhe këtë vjershë. Sipas të dhënave veprimi i saj mbi ungriotët që aq i madh, sa që menjëherë aty dollën të 500 luftëtarët vullnetarë, të cilët rrokën armët dhe me të arrihur Garibaldi në Kastrovillari, u bashkuan me të dhe e ndoqën gjer në Napoli.

Gjer kohët e fundit vjersha «Merori» njihesh nëpërmjet të ritregimit të përmbajtjes që dha në manualin e vet të letërsisë shqipe Albert Stratigo më 1896. I biri i poetit, Dr. Angelo Stratigo ruante një kopje në dorëshkrim, për fat të keq të cunuar, të cilën pati mirësinë të na e dhurojë. Pjesërisht kjo vjershë u botua për herë të parë në arbërishte dhe në shqipen e sotme në gazetën «Zëri i Rinisë» të 8 shkurtit 1964, Nr. 12.

Në këtë vjershë poeti i këndon ushtarit të popullit, që rroku pushkën dhe doli në sheshin e burrave për të luftuar armiqtë e vendit. Vepra thuret si tregimi patetik i akteve burrërore të birit të vegjëlisë për çlirimin e bashkimit e atdheut.

Pasi tregon për pjesëmarrjen e ushtarëve të popullit në çlirimin e Venedikut, poeti e shpije Merorin në luftën për çlirimin e Romës nga Papa.

Merori me veprimet e tija ushtarake trimërore hodhi përtej Tiverit papë dhe priftërinj, duke i dërguar këta të fundit që të vënë e të zënë bretkoca.

Kreve prrenje, hone, malje,  
Këmbit bëre gjak e kalje!  
Ziarrmi ndi zëmir t'frushkullon,  
Bënë peshk kur ljume shkon.  
Prapa Tevirit përmise  
Papin, me ne ti na kumbise  
Italien Romë, pir bretkë dirgove  
Priftrat, ma nënk kirkove  
Ne mish gjelji, ne kapuni!  
Mish kapoi e mish gjelji,  
Ka t'na e har' petritelji.

Në «Merori» Stratigo nëpërmjet të një aluzioni të qartë shprehu shqetësimin e vet për rezultatet e luftës së masave popullore dhe zëmërimin për pabesinë e klasave të larta, të cilët rronin rehat, duke mos bërë asnjë sakrificë për çlirimin e atdheut. Atij i qan zëmbra kur mendon se pasaniku «Skifteri rrëmbenjës» mund t'i lëshoj kthetrat e veta në «mishin e këndezit» d.m.th. të përvetësojë gjakun dhe sakrificat e bëra nga masat dhe merorit t'i mbesin pendët. «Po përse vallë skuqe dhe i vren turinjt? — pyet poeti. Mos vallë pse të kanë dhënë pendën, kurse të tjerët hanë mishin e këndezit. Jo ti, «mish për top», ti nuk do të hash kurrë mishin e këndezit, as të pulastrenit! Mishin e këndezit dhe të pulastrenit do ta hajë skifteri rrëmbenjës».

Vjersha «Merori» siç duket, u shkruajt gjatë viteve, kur ende nuk shiheshin rezultatet e hidhura të përpjekjeve e të sakrificave të masave popullore në luftën çlirimtare. Kjo rrethanë u pasqyrua në akordin opti-

mist me të cilën mbyllet vjersha. Poeti shpreh besimin se merori do të hajë mish këndezi:

E nani, ti trim, Meror,  
At pendë gjelji t'kalthëror,  
Çë tek shapka jote u ljidh,  
Trim, Meror, tunde e zdridh.  
Nani ti mund t'hash mish gjelji  
Ka t'hare pendit petritelji.

Por ngjarjet që pasuan nxorën në shesh besimin naiv të Stratigoit, se dinastia Savoja do të ngrinte një Itali të vegjëlisë së këputur. Ardhja në krye të vendit të forcave reaksionare, të borgjezisë së pasur të veriut në aleancë me aristokracinë e borgjezuar të jugut e me forcat klerikale, i shkaktoi Stratigoit një deluzion të rëndë. Kur e pa këtë, poeti, nuk e la veten ta kapi dëshpërimi i zi, por me fjalën e tij të fuqishme fshikulloi ashpër qeveritë antipopullore që erdhën në fuqi, arbitraritetin, forcën brutale dhe dhunimin e të drejtave të popullit.

Një vepër tjetër me brendi shoqërore të mprehtë e Stratigoit është vjersha «Proletarit». Me shpirtin e pastër të një njeriu të popullit, i indignuar nga padrejtësitë shoqërore që kanë goditur nga të gjitha anët masat, poeti, me ironi të fortë e figura të gjalla, tregoi vuajtjet e atij «çë ngë ka». Në «Proletari» është paraqitur jeta me kontraste të mprehta shoqërore, me kontradiktën e saj themelore në mes të proletarit, që roptohet dhe coptohet gjithë ditën e ditës dhe mbetet po me bark bosh dhe pasanikut, që thith pa mëshirë gjakun dhe djersën e punëtorit. Në fillim poeti numëron të mirat që i sjell shoqërisë punëtori, ai «çë ngë ka». Proletari, thotë poeti, ka luftuar, kur e ka lypur nevoja edhe si ushtar i mirë për të çliruar atdheun nga zgjedha e huaj. Tashti ai punon arën, harr vreshtat, mbledh e qeron ullinj e fiqt, nxjerr kripë nga deti, dhe bën shumë punë të tjera të dobishme për shoqërinë. Por megjithatë ai memzi e mban veten gjallë, duke e ngjyer kafshatën në lakër pa vaj e pa kripë.

Qërove fiq, ullinj qërove,  
Me një fik gojën s'ëmbëlsove ...  
Një lakër hëngre, po pa vaj,  
Atë kurriz rrope më gjak,  
Duke mbajtur krypë nga kryporja,  
Ti kur hëngre ndonjë patate,  
Pa kryp te goja jote hyri ...

Në të gjithë vjershën nuk ka gati asnjë varg, që të mos të të bëjë të ndalësh e të mendosh; vargjet janë plot pasion dhe kundra padrejtësisë shoqërore që lejon të shkelet i varfëri pa ligje e pa mëshirë dhe të shfrytëzohet si kafshë ai që i prodhon të gjitha të mirat e shoqërisë.

Të shoh të lëkurur, eshtrat në fëtyrë,  
Ty, o i mjerë, që pa tokë,  
Që pa shtëpi, pa kryq, pa qarë,  
Pa një dërrasë, si një të vrarë,  
Të zvarrisin nën dhe,  
Ty që gjakun derdhe për ne.  
Gjuhë për ty këmbora nuk ka,

Që sillje bukën që bota ha;  
 Ty që sharrove shumë drrasa qarri,  
 Si një copë dhe të shtinë te varri.  
 Shul i bukur i jetës tënde  
 Një degë lisi ish plot me lëndë  
 Lis i gjatë që rrufeja të zu,  
 Të këputi, të vrau, mbi truall të shtu.  
 Nëntë muaj ti qeve i sëmure;  
 Vdiqe eti, vdiqe urie...  
 Qe i sëmure, të lanë pa mjekime,  
 Ty pa tokë e pa shtëpi...

Është për t'u shënuar shpejtësia e antitezave të shumta po të dhëna në pak vargje, me të cilat poeti, me ironi të hollë e tërthorazi akuzon rëndë rendin shoqëror në fuqi:

Dhelprën gjumi e zë nën dhe,  
 Zogu i qiellës ka një fole.  
 Jashtë mbi një gur, o bir njeriu,  
 Gjumin ta këputi breshëri e shiu,  
 Për ty vetëm nuk ndizet zjarri, ...  
 Luteshe ti të ngordhi dhia,  
 Të blije një lëkurë, të qepje një gunë...

Në shumë vargje të kësaj vjershe në mes të zhurmës së shufrës plot ironi e sarkazëm kundra klasavet sundonjëse, zbulojmë simpatinë e poetit për punëtorin e aravet, për ushtarin e popullit dhe zëmërimin e tij të papërmbytur që frutin e punës së tyre e përvehtësojnë njerëzit që e kalojnë jetën pa punë.

Poeti vjershën e mbyll me një thirrje drejtuar nënës së punëtorit, një thirrje e fuqishme plot dashuri të ngrohtë, shprehur edhe në vargje të tjera e që tregon lidhjen e tij me masat punonjëse. Me mbylljen e vjershës plot optimizëm poeti i tregon nënës sigurimin e një shoqërie të drejtë në të ardhshmen:

Mëma plakë, nuk qan djalin  
 Që motët mizore ta vranë?  
 Shpata zëmrën tënde nuk e shpon?  
 Gjak nga zëmra nuk të vrushkullon?  
 Barku yt të xhveshur e nxuar,  
 Të xhveshur gjiu i dheut e muar.  
 Qetsohu! teri ato lot!  
 Me shërtime një det është plot...  
 Mëmë e dashur! Fytyrën mos çjerr,  
 Nuk di ti se yt bir  
 Është dielli i t'inzoti,  
 Që do të dalë kur të vijë moti,  
 Gjithë dhenë të ndriçojë,  
 Gjithë njerëzit të zbukurojë.  
 Yt bir është rrufeja, e kur të gjëmojë,  
 Do ta shtypë armikun, në varr do ta mblojë.

Po shoqëria e së ardhmes, shoqëri pa shfrytëzgjës dhe të shfrytëzuar, do të vijë, thotë poeti, me punën dhe përpjekjet e të gjithëve.

Jo, njeriu mbi njerinë  
S' do të rrojë si një ditë:  
Por së bashku do të punojnë,  
Që të nxjerrin nga veshklat pasuritë.

Më 1881, mbreti i Italisë, Umberto di Savoja, bashkë me mbretëreshën Margeritë, bëri një vizitë me qëllime propagandistike në Kalabri. Poeti Xhosuë Karduçi, më 1878, tre vjet para kësaj vizite, megjithëse republikan, i kishte kushtuar mbretëreshës një odë «Alla Regina d'Italia».

Karduçi, thotë Stratigoi, kishte kënduar hiret e mbretëreshës, duke derdhur lule e dritë rreth saj, kurse populli i Kalabrisë, me rastin e kësaj vizite e priti atë, mbretëreshën, bashkë me mbretin, duke i qëlluar me sheqerka të hidhura si lupinët, një lloj fare bimësh. Vincenc Stratigoi thuri një epigramë katër vargjesh plot satirë, ku bashkë me poetin republikan, Karduçin, goditi edhe mbretëreshën dhe me këtë tregoi antipatin' e tij dhe të popullit të Kalabrisë ndaj shtepisë Savoja, impopullaritetin e familjes mbretërore me masat e atyre krahinave të varfëra:

Tij çë Karduçi, oj Margeritë,  
Shprishi ljlulje, shprishi dritë,  
Na të shtimi kanaline,  
Çë janë tharta si lupine.

\* \* \*

Me përmbajtjen e tyre demokratike antifeudale dhe antiklerikale shkrimet e Stratigoit shenuan një hap të rëndësishëm përpara në zhvillimin e mendimit politik të arbëreshëve të Kalabrisë. Me fjalën e tij prej oratori dhe poeti të zjarrtë, me forcën depërtonjëse të ironisë dhe të sarkazmës, ai demaskoi rreptë rendin shoqëror në fuqi dhe mbrojti me vendosmëri dhe këmbëngulje për t'u admiruar vegjëlinë, shtresat punonjëse të popullit, tek të cilat kishte mbështetur shpresat e tija për shpëtimin e vendit nga zgjedha kapitaliste, feudale dhe klerikale dhe zhvillimin e tij në rrugën e lulëzimit ekonomik dhe të përparimit shoqëror.

Stratigoi vdiq në Ungër më 29 shtator 1885 i rrethuar nga dashuria e mirënjohja e masave të varfëra fshatare.

Jeta e tij prej revolucionari të patrembur, që sa i rregëtiu zëmra dhe i punoi krahu luftoi për një ideal të lartë, për çlirimin e vegjëlisë prej shtypjes dhe forcës brutale të klasave reaksionare, është një faqe e veçantë në historinë e traditave revolucionare të arbëreshëve të Italisë. Vepra e tij prej demokrati revolucionar dhe poeti socialist la gjurma në poezinë arbëreshe, e cila edhe më vonë do të bëjë jehonë aspiratave për drejtësi shoqërore, që vlonin në zëmrat e vegjëlisë arbëreshe.

Ëndërra e tij për drejtësi dhe barazi shoqërore u bë realitet në dheun e lashtë të arbëreshëve, në këtë anë të Adriatikut, ku masat popullore të drejtuar nga Partia, i dhanë shkelmin njëherë e përgjithmonë shtypjes klasore dhe u bënë zot të fatit të tyre.